

KONTRATË DHURIM KUOTE

Sot me datën 24/10/2023 (*dymijë e njëzete e tre*), lidhet kjo Kontratë Shitblerje Kuote (*në vijim referuar si "Kontrata"*), ndërmjet palëve si vijon:

DHURUESI:

Fadil Jata, atësia Elez, amësia Zylfie, shtetas Shqiptar, lindur në Bushtricë, Kukës dhe banues në KAMËZ, me adresë Liria 03840282; Nd. 31; H. 1; Kamëz; Kamëz; 1030; Kamëz, lindur më 25/05/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 033611463 dhe nr. personal G10525204H;

(*në vijim referuar si "Dhuruesi"*)

PRANUESI I DHURIMIT: *Sajmir Jata*, atësia Fadil, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Bushtricë, Kukës dhe banues në KAMËZ, me adresë Liria 03840282; Nd. 31; H. 1; Kamëz; Kamëz; 1030; Kamëz, lindur më 26/11/1990, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033602000 dhe nr. personal J01126092Q;

(*në vijim referuar si "Pranuesi i Dhurimit"*)

Këtu e në vijim Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen veçmas si "Palë" dhe së bashku si "Palët".

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht në *nenet 710 e vijues te Kodit Civil, nenet 72, 73 dhe 74 të Ligjit Nr.9901*, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe në *Nenin 15, Pika 7, të Statutit e Shoqërisë*, palët dakordësuan këtë Kontratë me përbajtje si më poshtë vijon:

MEQENËSE:

1. *Shoqëria "EURO VILA" sh.p.k*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS K91511003A, me adresë Rruga 'liria', Banesa Numer 21., (*në vijim referuar si "Shoqëria"*)
2. Bazuar në Ekstraktin e Shoqërisë, kapitali i saj është 100.000,00 (*njëqind mijë*) lekë dhe është i ndarë si vijon:
 - a. **Fadil Jata**, zotëruar i një kuote me vlerë nominale 100 000,00 (*njëqind mijë*) Lekë, që i korrespondonë 100 (*njëqind*) % të kapitalit të Shoqërisë;

3. Dhuruesi siç përshkruhet edhe me sipër, është ortaku i vetëm i Shoqërisë dhe zotërues të një kuote me vlerë nominale përkatësisht a)**Fadil Jata**, zotërues i një kuote me vlerë nominale 100 000,00 (*njëqind mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 100 (*njëqind*) % të kapitalit të Shoqërisë dhe shprehi dëshirën për dhurimin e një kuote në favor të Sajmir Jata që përkon me vlern nominale prej 50 000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që i korrespondon 50 (pesëdhjetë) %, e kapitalit të shoqërisë.
4. Pranuesi i dhurimit shprehet se dëshiron të bëhet pronar i pjesës/kuotës që Dhuruesi zotëron tek Shoqëria dhe rrjedhimisht të bëhen ortak me këto pjesë:
 - *Fadil Jata*, zotërues i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - *Sajmir Jata*, zotërues i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;

PËR KËTË ARSYE, në përputhje me sa më sipër, Palët bien dakord që të lidhin këtë Kontratë, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Transferimi me anë të Dhurimit, i pjesës/ kuotës që dhuruesi zotëron tek Shoqëria, përkatësisht a)**Fadil Jata**, zotërues i një kuote me vlerë nominale 100 000,00 (*njëqind mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 100 (*njëqind*) % të kapitalit të Shoqërisë, i dhuron ortakut të ri të shoqërisë Sajmir Jata një kuotë që përkon me vlerën nominale prej 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondon 50 (pesëdhjetë) %, e kapitalit të shoqërisë.

NENI 2 REGJISTRIMI I KONTRATËS

2.1 Kjo kontratë do të rregjistrohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit, pas nënshkrimit nga palët dhe bazuar në objektin e saj, ndarja e kuotave të ortakëve të shoqërisë Euro Vila sh.p.k, do të jetë për sa më poshtë vijon:

- a)*Fadil Jata*, zotërues i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
- b)*Sajmir Jata*, zotërues i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;

NENI 3 DEKLARIMET DHE GARANCITE E DHURUESIT

Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit

(a) *Pronar i Ligjshëm*

Dhuruesi deklaron dhe garanton se është pronari i ligjshëm i kuotës se zotëruar prej tij në Shoqëri identifikuar në dokumentet bashkëngjitur dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore, dhe/ose nuk i nevojitet asnjë tagër tjetër ligjor për të lidhur këtë kontrate, dhe për te përbushur detyrimet qe rrjedhin prej saj.

(b) *Barrët mbi Pronën*

Dhuruesi deklaron, se kuota e zotëruar prej tij në Shoqëri, objekt i kësaj Kontrate nuk është e ngarkuar me asnjë barrë, qoftë si peng, barrë siguruese apo barrë financiare (qofshin këto ligjore, gjyqësore apo kontraktore), apo të drejta të tjera të ngjashme me to, çdo e drejtë apo interes i dhënë me kontrate çdo personi, duke përfshirë çdo të drejte blerje, opzioni ose të drejte parablerje, dhënie përdorimi apo posedimi me kontrata të tjera, si dhe pa u kufizuar në to, çdo transaksion, veprim juridik a kufizim ligjor tjetër, përfshi këtu çdo vendim gjyqësor, përfundimtar apo të ndërmjetëm, vendim përmbarimor, apo të autoriteteve të tjera përcaktuar me ligj, i tillë që do të cenonte titullin e pronësisë së Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate.

(c) *Garancia*

Në bazë të njohurive më të mira të Dhuruesit, në datën e lidhjes së kësaj Kontrate nuk ekzistojnë pretendime nga të tretët, çështje gjyqësore në gjykim, të pezulluara ose të mundshme, pretendime ose vendime gjyqësore a masa sigurimi ne lidhje me kuotën objekt të transferimit sipas kësaj Kontrate dhe asnjëra prej këtyre padive, proceseve gjyqësore, masave dhe pretendimeve nuk ka të ngjarë të ndodhë; Të gjitha deklarimet dhe garancitë e Dhuruesit të paraqitura me sipër janë te vërteta dhe te sakta.

NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

4.1 Detyrimet e Dhururesit

(a) *Nënshkrimi i Akteve*

Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të nënshkruajë çdo akt e të kryeje çdo veprim juridik pa vonesa, kur i kërkohet nga Pranuesi i Dhurimit, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, e që mungesa e të cilit do te pengonte ushtrimin e plote, te pakushtëzuar e të pakufizuar prej Pranuesit të Dhurimit të së drejtës së tij të pronësisë mbi këtë kuotë.

(b) *Mbrojtja Gjyqësore*

Në rastin kur një palë e trete (përfshi autoritetet publike) ngrë pretendime dhe/ose bënë ankim gjyqësor për të kundërshtuar titullin e pronësisë të Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate, ose duke u bazuar në pretendime të mëparshme cënon apo kundërshton të drejtat që burojnë nga kjo kuotë, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të

thirret/ndërhyje në gjykimin e çështjes, dhe me shpenzimet e tij të mbrojë interesat e Pranuesit të Dhurimit si të ishin të tijat.

(c) *Cenimi i Titullit*

Pa kufizuar të drejtat e tjera të Pranuesit të Dhurimit të përcaktuar me ligj, Dhuruesi merr përsipër dhe detyrohet të mbrojë, zhdëmtojë, dëmshpërblejë, dhe ruajë Pranuesin e Dhurimit, ndaj dhe në vlerën e plotë të: (i) çdo detyrimi, dëmi, humbeje, apo shpenzimi, përfshi këtu shpenzimet e avokatit apo të ekspertëve të Dhuruesit që rezultojnë nga dokumente zyrtare (kontrata, fatura), të pasur nga Pranuesi i Dhurimit për t'u mbrojtur nga çdo pretendim, kërkese, apo padie, proces a vendim gjyqësor, përmbarimor të një të treti (*për qëllimet e këtij nenit, i tretë quhen edhe autoritetet publike kur veprojnë në rastet e parashikuara me ligj*) që duke u hequr si pronar i ligjshëm, kundërshton titullin e pronësisë të Pranuesit të Dhurimit mbi kuotën objekt transferim sipas kësaj Kontrate.

4.2 Detyrimet e Pranuesit të dhurimit

Pranuesi i dhurimit ka detyrimin e regjistrimit të kësaj kontrate në Qëndrën Kombëtare të Biznesit pas nënshkrimit të saj dhe me pas angazhohet që sipas të drejtave të reja që do të përfitojë në shoqërinë “Euro Vila” sh.p.k, do të ketë edhe detyrime sipas pjesës së tij.

Pranuesi i dhurimit angazhohet që, për çdo çështje që kërkohet në lidhje me shoqërinë, objektin e veprimtarisë së saj, kushtet financiare, zgjerimin apo zmadhimin e kapitalit, te jëtë i gatshëm për të vepruar sa më sipër në çdo kohë që kjo mund të kërkohet nga dhuruesi ose nga vetë pranuesi i dhurimit.

NENI 5

FORCAT MADHORE

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të mbajë përgjegjësi kundrejt tjetrës për mos përbushje, pjesërisht ose tërësisht, të detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate kur kryerja e tyre vonohet, pengohet ose ndalohet në rast të ndonjë Force Madhore;
- 5.2 Për qëllime të kësaj Kontrate, me “**Forcë Madhore**” do të kuptohet një ngjarje apo ndodhi përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve, e paparashikueshme, e pashmangshme, dhe që e bën të pamundur realizimin e detyrimeve të Palëve sipas kësaj Kontrate dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet e pamundur në rrethanat e ndodhura.
- 5.3 Ngjarje te Forcës Madhore do te konsiderohen por pa u kufizuar ne to:
 - a. luftëra, të shpallur ose jo, luftëra civile, trazirat dhe revolucionare, epidemë, akte sabotimi dhe/ose terrorizmi,

- b. tërmete, zjarre, shpërthime, stuhi, përbimitje ose kushte të tjera atmosferike të jashtëzakonshme,
 - c. bojkotet dhe/ose greva e çdo zaptimet e fabrikave dhe ambienteve, ndalimet e paligjshme të punimeve të cilat ndodhin në ambientet e Palës mospërmbushëse.
 - d. akte të autoriteteve, të ligjshme ose jo, përvëç akteve për të cilat Pala mospërmbushëse, ka marrë përsipër rrezikun në bazë të dispozitave të kësaj Kontrate.
- 5.4 Çdo Palë që pjesërisht ose plotësisht nuk është në gjendje të përbushë detyrimet sipas kësaj Kontrate, duhet t'i paraqesë një njoftim me shkrim palës tjetër lidhur me këtë fakt, duke dhënë me hollësi rrëthanat e kësaj Force Madhore;
- 5.5 Çdo Palë që pretendon se përbushja e detyrimeve te saj pengohet nga një ngjarje e Forcës Madhore duhet t'i bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ta larguar këtë Forcë Madhore dhe do t'i paraqesë menjëherë me shkrim Palës tjetër përfundimin ose mbarimin e shkakut të Forcës Madhore. Kjo Palë do t'i vazhdojë detyrimet e lëna pezull sa më parë të jetë e mundur pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore.

NENI 6

TË NDRYSHME

6.1 Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë, duke përfshirë Parashtrimet dhe Shtojcat bashkëngjitur saj, përbën tërësinë e marrëveshjes së lidhur ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj, dhe zëvendëson çdo ose të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Palëve në lidhje me kuotën objekt transferimi sipas kësaj Kontrate. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj Kontrate duhet të kryhet me shkrim dhe të miratohet nga palët pérndryshe do të konsiderohet e pavlefshme.

6.2 Veçueshmëria e Kontratës

Nëse ndonjë kusht apo dispozite e kësaj Kontrate shpallet e pavlefshme dhe/ose e paligjshme dhe/ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Kontratës, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Palët në mirëkuptim do të mundohen të zëvendësojnë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përbushjen e objektit të kësaj Kontrate.

6.3 Njoftimet

- a Çdo njoftim ose komunikim tjetër nga njëra Palë te Pala tjetër, i cili kërkohet ose lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate do të:
 - (i) bëhet në gjuhen shqipe;
 - (ii) behet me shkrim;

- (iii) dërgohet personalisht (dorazi) ose dërgohet me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me poste te shpejte në adresën e Palës tjetër, e cila është paraqitur më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër të cilën do ta kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër, dhe
- (iv) shënohet në vëmendje të personit(ave) të përcaktuar më poshtë ose të person(ave) të tjere të tillë që mund t'i kërkojë me anë njoftimi Pala tjetër.
- b Për efekt njoftimi sipas klauzolës së mësipërme (a) të këtij nenit, palët deklarojnë adresat e poshtëshënuara:

Për Dhuruesin: Fadil Jata

Adresa: Kamëz, Rruga "Liria"

Tel: 0682033112

Për Pranuesin e Dhurimit: Sajmir Jata

Adresa: Kamëz, Rruga "Liria"

Tel: 0684040405

- c Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë te tetra, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër nëse është dërguar dorazi në ditën që është lënë në adresën e mëposhtme të palës tjetër (siç mund të ndryshohet herë pas herë me njoftimin e arsyeshëm të kryer nga secila Palë te Pala tjetër), nëse është dërguar me anë të postës së regjistruar me parapagim ose me postë te shpejte dyzet e tetë orë (48) nga data e postimit, ose nëse është dërguar me faks, siç është parashikuar më sipër, në adresat e deklaruara prej palëve.

NENI 7

EFEKTE LIGJORE

- 7.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe likuidimin e çmimit te blerjes, Blerësi bëhet pronar me të drejta të plota të kuotës së blerë, sipas përcaktimit të Objektit të kësaj Kontrate, si më sipër, dhe Shiteti zhvishet nga çdo e drejtë lidhur me këtë kuotë.
- 7.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, pjesëmarja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:
- Z.Fadil Jata, zotëruar i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
 - Z.Sajmir Jata, zotëruar i një kuote me vlerë nominale 50 000,00 (*pesëdhjetë mijë*) Lekë, që i korrespondojnë 50 (*pesëdhjetë*) % të kapitalit të Shoqërisë;
- 7.3 Pranuesi i Dhurimit merr përsipër, që do të kryejë të gjitha veprimet përkatëse për të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB") këtë Kontrate dhe ndryshimet përkatëse në kuotat e Shoqërisë sipas pikës 2 të këtij Neni të Kontratës.

NENI 8

LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1 Kjo Kontrate hartohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe vlefshmëria dhe realizimi i saj do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Për sa nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur në këtë Kontrate, do të zbatohen parashikimet e Ligjit Shqiptar.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

- 9.1 Nëse midis palëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e mosmarrëveshjes. Pas njoftimit Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 9.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me sa më sipër brenda 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga marrja e njoftimit të parashikuar më sipër, çdo Mosmarrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

DISPOZITA PERFUNDIMTARE


Kjo kontratë është përgatitur në Shqip, në 4 (*katër*) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Kjo Kontratë hyn në fuqi ne datën e nënshkrimit te saj nga palët.

Palët pasi lexuan Kontratën bien dakord me sa është përcaktuar më sipër dhe konfirmojnë se ajo është përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të pa vesuar.


DHURUESI

Fadil Jata


FADIL JATA
F. JATA

PRANUESI I DHURIMIT

Sajmir Jata


Sajmir Jata
S. JATA